

VENDIM
Nr. 180, datë 8.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 881, DATË 20.12.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN
E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 23/2015, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 881, datë 20.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe përcaktimin e kategorisë së pagës të nëpunësve me grada diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme.”.

b) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 1/1 dhe lidhja nr. 2, që përmendet në këtë pikë, shfuqizohen.

ç) Pika 5 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Elementët e pagës për secilën kategori të përcaktuar në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2017, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikën e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1

GRADA DIPLOMATIKE	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Ambasador	Sekretar i Përgjithshëm	I-b
Ministër Fuqplotë Ministër Këshilltar Konsull i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	II-a
Këshilltar	Drejtor	II-b
Sekretar i parë Konsull	Përgjegjës sektori	III-a
Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	Specialist	III-b
Sekretar i tretë Agjent Konsullor	Specialist	IV-a
Atashe	Specialist	IV-b